



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministrastvo Administracije Lokalne Samuprave
Ministry of Local Government Administration

2014, RAPORT GJASHTËMUJOR

Funksionimi i kuvendeve të komunave

KUVENDET E KOMUNAVE | KOMITETET E KUVENDIT | AKTET E MIRATUARA
TRANSPARENCA | KKSBB | RISHIKIMI ADMINISTRATIV



Botues: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Mbikëqyrja: Agron Maxhuni, Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave
Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave

Hartues:

Diellor Gashi , Zyrtar i lartë për monitorim të Komunave

Të dhënat janë mbledhur nga zyrtarët përgjegjës të moniorimit:

1. Kujtim Aliu
2. Jeton Qela
3. Gzim Sahiti
4. Manushaqe Muçaj
5. Andrijana Disic
6. Ramadan Potera
7. Driton Xhafa

Përgatitja teknike:

Diellor Gashi

RAPORT

FUNKSIONIMI I KUVENDEVE TË
KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS



SHËRHYSH

Viti 2014 shënoi përfundimin e inaugurimit të organeve të komunave të Republikës së Kosovës të dala nga zgjedhjet lokale. Gjatë kësaj periudhe janë konstituuar të gjitha organet komunale duke ruajtur kontinuitetin e punës së organeve komunale në shërbim të qytetarëve. Komunitat kanë qenë mjaft aktive në kryerjen e obligimeve ligjore, duke ndërtuar një nivel të mirë të bashkëpunimit në mes organeve komunale.

Gjatë periudhës janar-qershor 2014 janë konstituuar komitetet e obligueshme, janë themeluar komitete të tjera, ka filluar procedura e themelimit të komiteteve konsultative, e po ashtu janë paraparë pozitat e përcaktuara me ligjin për vetëqeverisje lokale në funksion të përfaqësimit të komuniteteve joshumicë. Njëkohësisht është vërejtur respektimi i kuotës gjinore me rastin e përfaqësimit në kuvendet e komunave, në themelimin e komiteteve dhe komisioneve në nivel të komunës, si dhe mekanizmave të tjerë në nivel lokal.

Si fillim komunitat kanë miratuar agjendën vjetore të punës së kuvendeve të tyre dhe njëkohësisht ekzekutivi i komunës është kompletuar me emërimin e drejtorëve në drejtoratet e komunës. Përgjithësisht ka pasur një koordinim në komuna për realizimin e projekteve dhe planeve investuese sipas listës së projekteve të miratuara në vitin paraprak të përcjella me buxhetin e miratuar. Është vërejtur një konsolidim i komunave në themelimin e komisioneve për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, si një aset mjaft i rëndësishëm i pasurisë komunale. Ajo që duhet përmendur është fakti i ndërtimit të bashkëpunimit të mirë me komunitatet veriore të Republikës së Kosovës, ku është arritur të sigurohen të gjitha parakushtet e nevojshme për monitorimin e tyre.

Në përputhje me përgjegjësitë ligjore dhe mandatin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave, përkatësisht Divizioni i Monitorimit të Komunave, ka mbikëqyrë punën e Komunave të Republikës së Kosovës në të gjitha çështjet e përshkruara më lartë. Pikësynim kryesor i këtij procesi ka qenë monitorimi i të gjitha komunave dhe siguri që kjo veprimtari të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Struktura e raportit

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal harton rregullisht raportin gjashtëmujor të funksionimit të kuvendeve të komunave. Përmes këtij raporti synojmë të vlerësojmë progresin e komunave në përmbushjen e obligimeve ligjore, zbatimin e kompetencave të tyre, si dhe nivelin e përmbushjes së përgjegjësisë që lidhen me realizimin e kërkesave dhe interesave të qytetarëve.

Ky raport ndjek strukturën e mëposhtme:

- Raporti përshkruan funksionimin e kuvendeve të komunave;
- Përshkruan themelimin e komiteteve të obligueshme dhe atyre fakultative duke paraqitur numrin e takimeve, llojet e tyre si dhe aspekte krahasuese mes komunave;
- Ofron të dhëna krahasuese për organizimin e takimeve të obligueshme publike me qytetarë;
- Analizon të dhënat e akteve komunale të miratuara.
- Pasqyron shkeljet ligjore të evidentuara, dhe
- Shqyrton hapat e komunave ndaj kërkesave për rishqyrtim nga autoriteti mbikëqyrës.

Raporti përfshinë periudhën nga janari deri në fund të muajit qershor 2014. Përjashtimisht tek pjesa e rishqyrtimit të akteve të kundërligjshme janë azhurnuar të dhëna në mënyrë që treguesit e veprimeve të komunave të paraqesin progres në implementimin e rekomandimeve dhe evitimin e joligjshmërisë. Raporti bazohet në të dhënat e mbledhura nga zyrtarët monitorues të Divizionit për Monitorim të komunave, monitorimit elektronik dhe një pjesë nga monitorimi i drejtpërdrejtë. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal nxjerr konkluzione të detajuara lidhur me funksionimin e organeve komunale dhe hapave të cilët komunat duhet ndërmarrin në të ardhmen.

Qëllimi i Raportit

Raporti ka për qëllim informimin e drejtë të institucioneve qendrore, komunave, të qytetarëve, organizatave joqeveritare, dhe çdo grupi tjetër të interesit, për nivelin e funksionimit të kuvendeve të komunave dhe mekanizmave të tjerë përcjellës. Përmes këtij raporti mundohemi të krijojmë një përfytyrim të qartë për qytetarët, lidhur me aktivitetet e të zgjedhurve të tyre lokal. Gjithashtu, raporti shërben si një mjet adekuat për të rritur transparencën e organeve të pushtetit lokal.

Në kuadër të raportit, janë përfshirë të dhënat për 38 komuna të Republikës së Kosovës.

Vlerësojmë se informacionet e ofruara në këtë raport, e në veçanti gjetjet e paraqitura, do të shërbejnë në të mirë të proceseve të vetëqeverisjes lokale, të rrisin përgjegjësinë institucionale dhe komunat të ndërmarrin hapa konkret në përmirësimin e veprimeve kundërligjore.



Funksionimi i kuvendeve të komunave

Mbledhjet e kuvendeve të komunave

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë vendimarrës i komunës dhe njëkohësisht organi mbikëqyrës i autorizuar ligjërisht për sigurimin e ofrimit të shërbimeve nga ana e ekzekutivit të komunës, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kuvendi i Komunës duhet mbledhet rregullisht në mënyrë që të kryej funksionet në kuadër të fushëveprimtarisë së tij, për të miratuar aktet normative të nevojshme për komunën, të cilat kërkohen shprehimisht me legjislacionin në fuqi.

Ligji për Vetëqeverisje Lokale ka përcaktuar disa rregulla që i referohen mbajtjes së takimeve të Kuvendit të Komunës, në mënyrë që të ketë njëtrajtshmëri të punës së këtij organi. Ky ligj ka normuar mbajtjen

e së paku 10 mbledhjeve në vit të kuvendit të komunës, pesë prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit¹. Për nga numri në këtë periudhë janë mbajtur 206 mbledhje të rregullta dhe 20 të jashtëzakonshme të kuvendeve të komunave. Në vijim në formë grafike kemi paraqitur numrin e mbledhjeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme në kuvendet e komunave:

Nga figura e mësipërme shihet se numrin më të madh të mbledhjeve e kanë mbajtur komunat: Gjilan, Istog, Lipjan, Suharekë, Glogovc, Dragash, Klinë, Fushë Kosovë, Kamenicë, Obiliq, Rahovec, Skenderaj, Ferizaj, Viti, Vushtrri, Malishevë, Hani i Elezit, Mamushë dhe Junik. Me përjashtim të Komunës së Deçanit dhe Zubin Potokut, të gjitha komunat kanë mbajtur numrin e mjaftueshëm prej 5 mbledhjeve brenda gjashtëmujorit të parë të vitit, ashtu siç

kërkohet me nenin 43.2 të Ligjit për vetëqeverisje lokale.

Njoftimet për mbledhje dhe materialet përcjellëse

Me përjashtim të Komunës së Mitrovicës Veriore e cila ftesën (njoftimin) për mbledhje nuk ka dërguar asnjëherë gjatë kësaj periudhe, të gjitha komunat tjera kanë kryer obligimin për njoftim në raport me MAPL-në. Mirëpo, disa komuna kanë dështuar që së bashku me ftesën për mbledhje të dërgojnë në organin mbikëqyrës edhe materialet përcjellëse edhe pse të obliguara me nenin 43.3 (pika e) të Ligjit për vetëqeverisje lokale. Në këtë grup të komunave bëjnë pjesë: Deçani, Fushë Kosova (në dy raste), Leposaviqi, Peja (me vonesë), Mitrovica Veriore, Zveçani dhe Zubin Potoku.

Mbledhjet e kuvendeve të komunave




Fig.1. Numri i mbledhjeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme të kuvendeve të komunave

¹ Ligji nr.03 L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 43.2.

Komitetet e obligueshme

Me konstituimin e kuvendeve të komunave pas mbajtjes së zgjedhjeve lokale, komunat janë angazhuar të themelojnë trupat e kuvendeve si mekanizma mbështetës për kryerjen e punëve të kuvendit. Sipas LVL-së, kuvendet e komunave themelojnë komitete të obligueshme për të mbështetur punën e tyre. Ato janë të obliguara për të themeluar Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, si komitete të përhershme.

Si rregull, mbledhjet e komiteve mbahen para mbledhjeve të kuvendeve, duke marrë parasysh përgjegjësitë e dhëna me Ligjin për vetëqeverisje lokale. Megjithatë, vërejmë se komitetet për komunitete në këtë gjashtëmujor janë treguar më pak aktive në krahasim me mbledhjet e kuvendeve të komunave. Numri i takimeve të komiteve të obligueshme është paraqitur si në fig 2. Nga figura e mëposhtme vërejmë se Komiteti për Komunitete ka dështuar të mbledhet në komunat: Glogovc, Mitrovicë

Veriore, Leposaviç, Zubin Potok dhe Zvečan. Në anën tjetër, Komiteti për Komunitete po ashtu ka qenë jo aktiv në komunat: Ranillug, Junik, Mamushë, Podujevë, Obiliq, Novobërdë, Mitrovicë Jugore, Kaçanik dhe Deçan. Në total, komitetet për politikë dhe financa në komuna kanë mbajtur 168 takime, kurse komitetet për komunitete 112 takime. Krahasuar aktivitetin e tyre, shihet se komiteti për komunitete ka mbajtur 56 takime më pak se sa Komiteti për politikë dhe financa.

Komitetet e obligueshme




Fig.2. Numri i mbledhjeve të komiteteve të obligueshme

Komitetet tjera

Varësisht nga specifikat e komunave, ato "themelojnë komitete të tjera për të cilat konsideron se janë të nevojshme për kryerjen e përgjegjësi të tyre"². Gjatë kësaj periudhe është parë se një pjesë e madhe e komunave kanë themeluar komitete të tjera në fushat si: Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale; Arsim dhe Kulturë; Zhvillim Ekonomik; Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtjen e mjedisit etj. Në vijim në formë grafike kemi paraqitur numrin e komunave të cilat kanë themeluar komitete të tjera:




Fig.3. Numri dhe llojet e komiteteve të tjera të themeluara në komuna

² Ligji nr.03 L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 51.2

Komunat	Komiteti për Shëndetësi dhe mirëqenie sociale	Komiteti për Arsimit	Komiteti për Planifikim Urban	Komiteti për Bujqësi	Komiteti për Zhvillim Ekonomik	Komiteti për Diasporë	Komiteti për shërbime publike	Komiteti për Pronë	Komiteti për persona me aftësi të kufizuara	Komiteti për kategoritë e dala nga lufta	Komiteti për mbrojtje dhe shpëtim	Komiteti për Kthim dhe riintegrim
Lipjan	1	1	1	1								
Malishevë	1	1	1			1						
Pejë	1	1	1		1							
Klinë		1	1				1	1				
Viti												
Hani i Elezit												
Gjilan	1	1	1		1			1				1
Gjakovë	1	1			1				1			
Mitrovicë Jugore	1	1	1		1		1					
Ferizaj	1	1	1		1				1	1		
Shtime							1					
Prishtinë	1	1	1		1		1	1				
Skenderaj											1	
Total	8	9	8	1	6	1	4	3	2	1	1	1

Tab.1. Të dhënat për themelimin e komiteteve të tjera

Siç shohim nga grafiku dhe tabela më sipërme, në komuna janë themeluar gjithsej 45 komitete të tjera në fushat e paraqitura si më lartë. Prej tyre më së shumti i është kushtuar rëndësi Komitetit për Shëndetësi, Arsimit dhe në fushën e urbanizmit, derisa janë themeluar edhe

disa komitete të veçanta siç është ai për diasporë (Malishevë), Komiteti për kategoritë e dala nga lufta (Ferizaj), Persona me aftësi të kufizuara (Ferizaj, Gjakovë), mbrojtje dhe shpëtim (Skenderaj) si dhe komiteti për ri-integrim (Gjilan). Megjithatë, në pak raste është vërejtur

se këto komitete shqyrtojnë politika të natyrës për të cilën janë themeluar, ngase rolin kryesor e kryejnë komitetet e përhershme. Pengesë është parë edhe mungesa e kompensimit të punës së këtyre komiteteve që ka ndikuar në uljen e ritmit të punës së tyre.

Komitetet Konsultative



Sipas LVL-së, kuvendet e komunave themelojnë komitetet e obligueshme të natyrës konsultative për të mbështetur punën e tyre. Këto komitete duhet të themelohen për sektor specifik të cilat i përcakton komuna sipas prioriteteve. Për ta bërë këtë, Kuvendi i Komunës do të themelojë komitetet konsultative brenda sektorëve me qëllim që të bëjë të mundur pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendim marrjes. Sipas të dhënave, vendimet për themelimin e komiteve konsultative e janë miratuar në vetëm 7 komuna, siç janë: Novobërda, Mitrovica, Vitia, Hani i Elezit, Klinë, Podujeva dhe Prishtina

Shohim se në 7 komuna janë miratuar vendimet për themelimin e 20 komiteve konsultative në 11 fushat e paraqitura si në fig.4. Prej komiteve konsultative të themeluara, vetëm komuna e Prishtinës dhe Novobërdës nuk kanë përcaktuar qëllimin apo fushën për të cilën janë nxjerrë vendimet për themelimin e këtyre komiteve. Më poshtë është paraqitur tabela për llojet e komiteve konsultative sipas komunave që i kanë themeluar:




Fig.4. Numri dhe llojet e komiteve konsultative të themeluara në komuna

Komunat	Novobërda	Mitrovicë Jugore	Lipjan	Viti	Hani i Elezit	Klinë	Podujevë	Prishtina	Total
Komiteti konsultativ për shëndetësi dhe mirëqenie sociale		1		1	1				3
Komiteti konsultativ për arsim, kulturë, rini dhe sport		1		1	1				3
Komiteti konsultativ për shërbime publike dhe zhvillim ekonomik		1	1	1	1				4
Komiteti për planifikim urban dhe mbrojtje të ambientit		1		1	1				3
Komiteti për persona me aftësi të kufizuara		1							1
Komiteti konsultativ për çështje emergjente						1			1
Komiteti për bujqësi, zhvillim rural dhe mbrojtje të mjedisit						1			1
Komiteti konsultativ për zhvillim ekonomik							1		1
Komiteti konsultativ për mbrojtje të ambientit							1		1
Komiteti konsultativ për barazi gjinore dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut							1		1
Komiteti konsultativ i pa-specifikuar	1							1	2

Tab.2. Numri dhe llojet e komiteve konsultative sipas komunave



Takimet publike me qytetarë

Komunat janë po ashtu janë të obliguara të zbatojnë rregullat të cilat sjellin mekanizmin e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje. Ky mekanizëm sigurohet në mes tjerash edhe përmes takimeve me qytetarë. LVL, në mënyrë të veçantë ka specifikuar konsultimet gjithëpërfshirëse, ku kërkohet mbajtja e së paku dy takimeve publike brenda një viti (neni 68.1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale). Të dhënat e në figurën nr. 6 tregojnë numrin e takimeve të organizuara me qytetarë.

1 Komunat të cilat nuk kanë mbajtur takime gjithëpërfshirëse me qytetarë:

1. Prishtinë
2. Istog,
3. Mitrovicë veriore
4. Leposaviq, Novobërdë,
5. Rahovec,
6. Pejë
7. Skenderaj
8. Zubin Potok
9. Zveçan

Nga figura e paraqitur vërejmë se 26 komuna janë brenda normës ligjore të përcaktuar, kurse 10 komunat si: Istog, Prishtinë, Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Novobërdë, Rahovec, Pejë, Skenderaj, Zubin Potok dhe Zveçan, nuk kanë mbajtur asnjë takim me qytetarë (sipas nenit 68.1 të LVL-së). Duhet shtuar, se komunat kanë mbajtur takime të tjera me qytetarë, nëpër vendbanime, lagje, fshatra të cilat cilësohen komplementare në krahasim me takimet gjithëpërfshirëse të cilat janë të obligueshme.




Fig.6. Numri i takimeve publike me qytetarë sipas komunave



Raportimi i kryetarit në Kuvendin e Komunës

Një ndër përgjegjësitë e kryetarit të komunës është edhe raportimi para kuvendit të komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe zbatimin e planeve investuese në komunë, së paku një herë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës (neni 58, pika j e LVL-së). Duke marr parasysh këtë, janë


mbledhur të dhënat për numrin e raportimeve të kryetarëve në kuvendin e komunave. Sipas të dhënave del që në 38 komuna kemi 37 raportime, mirëpo janë 6 komuna në të cilat kryetarët e tyre nuk kanë raportuar fare në kuvendin e komunës. Në vijim është paraqitur tabela për numrin e raportimeve sipas komunave:

2

Kryetarët komunave të cilët nuk kanë raportuar para kuvendit janë, si në vijim:

1. Klinë
2. Mitrovicë Veriore,
3. Leposaviq
4. Zubin Potok,
5. Zveçan
6. Malishevë

Raportimet e kryetarëve të komunave për situatën ekonomike-financiare



■ Numri i raportimeve

Fig 7. Të dhënat për numrin e raportimeve të kryetarëve të komunave

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI




Në nivelin lokal, trupa me rëndësi për sigurinë publike të qytetarëve por edhe më gjerë janë Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSBB).

Themelimi i KKSBB-së bazën ligjore e ka me Ligjin për Policinë, ndërsa përbërja, mënyra e funksionimit dhe obligimet tjera fillimisht janë përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2009 MPB-02/2009 MAPL. Me ndryshimet e bëra me Udhëzimin Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, është definuar edhe më qartë pozicioni i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në raport me komunën.

Me ndryshimin e Udhëzimit Administrativ për KKSBB, është përcaktuar roli preventiv i këtij Këshilli ndaj dukurive negative në shoqëri dhe janë përcaktuar një numër i objektivave me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve për natyrën e krimeve, parregullsive dhe sjelljeve të dhunshme në komunitetin lokal, identifikimin e brengave të qytetarëve dhe përfaqësimit e pikëpamjeve dhe shqetësimeve të qytetarëve për çështjet e krimit. Për më tepër, me ndryshimet normative, çështja e sigurisë i lihet më tepër në kompetencë komunave, duke përcaktuar të drejtën e Kuvendit të Komunës në themelimin e KKSBB-së me vendim dhe përgjegjësinë e kryetarit të komunës për të bërë më funksionale këtë organ. Ndër të tjera është rregulluar edhe numri minimal prej gjashtë takimeve që duhet mbajtur KKSBB gjatë një viti, tri prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë³. Për numrin e takimeve, është paraqitur skema në vijim sipas komunave:

KKSBB



■ Numri i takimeve të KKSBB-së

Fig.8. Numri i takimeve të KKSBB-së sipas komunave

³ Udhëzim Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, neni 11.2.


Aktet e kuvendeve të komunave

Në periudhën janar-qershor 2014, kuvendet e komunave kanë miratuar gjithsej 1031 vendime dhe 62 rregullore. Shihet se për nga numri, komunat kanë qenë mjaft aktive në nxjerrjen e akteve juridike nënligjore. Aktet e nxjerra gjatë kësaj periudhe rregullojnë fushave të ndryshme, mirëpo më kryesoret mund të përmendim: Vendimet për themelimin e komiteteve të obligueshme, komiteteve të tjera, KKSBB-së, planeve

vjetore të punës, miratimin e planeve rregulluese urbane, miratimi e akteve nga fusha e mjedisit, akteve lidhur me shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të komunës, akteve për emërtimin e rrugëve, sferës së shërbimeve publike, akteve të karakterit financiar, pastaj themelimin e komisioneve të ndryshme për nevoja të brendshme etj. Për nga aspekti numerik, në vijim është prezantuar grafiku i akteve të miratuara sipas komunave:

1031 Vendime
62 Rregullore

Aktet e miratuara në kuvendet e komunave



Fit.9. Numri i akteve të miratuara në kuvendet e komunave



Sipas të dhënave më së shumti vendime kanë miratuar kuvendet e komunave: Ferizaj, Mitrovicë jugore, Gjakovë,

Malishevë, Shtime dhe Obiliq. Kurse rregullore më së shumti janë miratuar në kuvendet e komunave: Viti, Vushtrri, Graçanicë, Partesh dhe Lipjan. Në tërësi, më pak aktive në nxjerrjen e akteve juridike kanë qenë kuvendet e komunave: Mitrovicë Veriore, Deçan, Dragash, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Junik. Sa u përket llojeve të akteve, duhet përmendur vendimet të cilat rregullojnë fushën e menaxhimit të pronës së paluajtshme komunale. Gjatë kësaj periudhe, një numër i madh i komunave kanë themeluar Komisionet

për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Këto komisione janë themeluar në komunat: Prishtinë, Skenderaj, Vushtrri, Suharekë, Glogovac, Gjilan, Rahovec, Dragash, Fushë-Kosova, Klinë, Prishtinë, Vushtrri, Pejë, Istog, Lipjan, Kamenicë, Mitrovicë e Jugut, Shtime, Podujevë, Viti, Gjakovë, Prizren, Ferizaj, Rahoveci.

Kurse, Komisioni për ankesa është themeluar në komunat: Klinë, Vushtrri, Dragash, Mitrovicë e Jugut, Ferizaj, Lipjan dhe Gjilan, Rahovec.

Funksionimi i faqeve elektronike të komunave

Funksionimi dhe përdorimi i faqeve zyrtare të internetit të komunave rregullohet me Udhëzimin Administrativ Nr.03/2011 për Ueb-faqet e Institucioneve Publike. Çështjet e tjera të përdorimit të ueb-faqeve zyrtare të komunave që lidhen me transparencën komunale, publikimin e akteve komunale dhe informimin e publikut janë të rregulluara me norma të veçanta të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ Nr.2008/3 për ndryshimin e U.A. Nr.2006/03 për "Transparencën në Komunë" dhe Rregulloren Nr. 01-2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin


e Akteve të Komunave.

Referuar këtyre rregullave, komunat janë përgjegjëse që në mes tjerash të respektojnë parimin e transparencës, të krijojnë lehtësira për qasje të publikut në informacionet dhe ngjarjet e komunave, si dhe të krijojnë mundësinë për qasje më të lehtë në dokumentet zyrtare të komunës. Si mjet kryesor për të ofruar qasjen e publikut në këto të dhëna, janë faqet zyrtare elektronike të komunave. Marrë parasysh se komunat kanë aktivitete të ndryshme përbrenda institucioneve të tyre, është paraparë si e domosdoshme që futja e të dhënave në ueb faqet komunale të jetë e vazhdueshme, ngase qytetarëve i'u mundëson të jenë më të informuar lidhur me rrethanat dhe ecjet e komunës.

1093 akte të miratuara
740 akte të publikuara:
353 akte të pa-publikuara:

Publikimi i akteve në faqet elektronike të Komunave

Përgjegjësia për publikimin e akteve të Komunave dhe përditësimin e faqeve elektronike zyrtare të komunave me aktet juridike të miratuara është rregulluar me Rregulloren Nr. 01-2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunave. Gjatë kësaj periudhe raportuese, përditësimi i faqeve elektronike të komunave me aktet e miratuara nuk ka qenë koherent. Më poshtë është paraqitur grafiku me të dhënat sipas komunave, lidhur me publikimin e akteve në faqet elektronike:



Publikimi i akteve në faqet elektronike të komunave




Fig.10. Të dhënat për numrin e akteve të publikuara në faqet elektronike të komunave

Nga të dhënat e prezantuara më lartë del që pjesa më e madhe e komunave nuk i kanë azhurnuar me rregull ueb-faqet komunale me dokumentet zyrtare. Nëse krahasojmë numrin e akteve të miratuara me ato të publikuara vërejmë se nga gjithsej 1093 akte (vendime dhe rregullore) të miratuara në kuvendet e komunave, janë publikuar 740 akte, kurse 353 nuk janë publikuar.


Figura e mësipërme tregon se komunat të cilat i kanë publikuar të gjitha aktet e miratuara në kuvendin e komunës janë: Glogovci, Kamenica, Lipjani, Podujeva, Prishtina, Skenderaj, Ferizaj, Prizren, Kaçaniku, Klina, Vushtrria, Malisheva, Suhareka, Juniku dhe Ranillugu. Krahas tyre, komunat të cilat nuk i kanë të gjitha aktet janë:

Gjakova, Peja, Gjilani, Dragashi, Istogu, Fushë-Kosova, Mitrovica Jugore, Obiliq, Shtime, Viti, Hani i Elezit, Graçanica dhe Parteshi. Për dallim nga këto, komunat të cilat nuk i kanë publikuar fare aktet e miratuara në kuvendet e komunave janë: Deçani, Mitrovica Veriore, Leposaviqi, Novobërda, Rahoveci, Shtërpca, Zubin Potoku, Zveçani, Mamusha dhe Klllokoti.

Sipas rregullores së përmendur më lartë, "aktet nënligjore të komunës hyjnë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës". Prandaj, publikimi është mjaft i rëndësishëm duke marrë parasysh hyrjen në fuqi të akteve juridike të komunës si dhe rritjen e transparencës në komunë.

Komunat të cilat nuk i kanë publikuar aktet e kuvendeve në ueb-faqet zyrtare:

1. Deçani
2. Mitrovica Veriore,
3. Leposaviqi,
4. Novobërda,
5. Rahoveci,
6. Shtërpca,
7. Zubin Potoku, Zveçani,
8. Mamusha dhe
9. Klllokoti.



⁴ Rregullorja Nr.01-2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunave, neni 18.1.



Shqyrtimi i ligjshmërisë SË AKTEVE TË KOMUNAVE

MAPL është autoritet mbikëqyrës i komunave për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve për të cilat shprehimisht nuk është kompetent ndonjë autoritet tjetër. Komunitet kanë përgjegjësi që sipas nenit 80 të LVL-së të

dërgojnë aktet e miratuara nga kuvendi për shqyrtim të ligjshmërisë në organin mbikëqyrës. Derisa në një periudhë komunat kanë paraqitur pengesa në dërgimin e akteve dhe nuk ka pasur një koordinim të mirë mes

tyre dhe nivelit qendror, tani të gjitha komunat kanë rregulluar këtë aspekt. Sipas të dhënave, gjatë periudhës raportuese nuk është evidentuar asnjë komunë të mos ketë dërguar aktet për shqyrtim të ligjshmërisë.

Në vijim, është prezantuar figura me numrin e konfirmimeve të ligjshmërisë së akteve të komunave nga autoriteti mbikëqyrës, përkatësisht MAPL dhe komisionet sektoriale në ministritë e linjës:

Konfirmimi i ligjshmërisë




Fig.11. Të dhënat për numrin e akteve të shqyrtuara nga MAPL dhe ministritë sektoriale

Ashtu siç shihet në figurën e mësipërme, në total janë vlerësuar 1008 akte të komunave, prej të cilave 758 nga MAPL dhe 250 nga komisionet sektoriale. Pjesa tjetër e akteve të pashqyrtuara janë në procedurë të shqyrtimit, kryesisht për shkak të nxjerrjes së tyre në fund të muajit qershor dhe pritjes për pranim të akteve sipas afatit ligjor.

KUVENDET E KOMUNAVE TË CILAT KANË BËRË SHKELJE LIGJORE MË RASTIN E NXJERRJES SË AKTEVE JANË:

- 2 vendime - **Gjakovë**
- 1 Plotësim-ndryshim i Rregullores - **Glogoc**
- 2 vendim - **Rahovec**
- 1 vendim - **Dragash**
- 1 vendim - **Istog**
- 1 vendim - **Klinë**
- 3 vendime - **Kamenicë**
- 1 vendim - **Mitrovicë Jugore**
- 1 miratim i Statutit - **Mitrovica Veriore**
- 1 miratim i Statutit - **Leposaviq**
- 1 vendim - **Lipjan**
- 1 vendim - **Novobërdë**
- 2 vendime - **Rahovec**
- 1 vendim - **Pejë**
- 1 Rregullore - **Prishtinë**
- 1 vendim - **Shtime**
- 1 vendim - **Suharekë**
- 1 vendim - **Ferizaj**
- 2 miratimi i Statutit dhe 1 Vendim - **Zubin Potok**
- 3 miratimi i Statutit dhe 2 Vendime - **Zvečan**
- 4 vendime - **Graçanicë**
- 1 vendim - **Partesh**

Shkeljet ligjore të evidentuara

Në bazë të vlerësimit të ligjshmërisë së akteve të komunave, MAPL ka konstatuar këtë gjendje lidhur me ligjshmërinë e akteve të komunave:

Nga 1008 akte (vendime dhe rregullore) të vlerësuara janë evidentuar 31 akte që nuk janë në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi.

Për të gjitha këto akte, MAPL dhe komisionet përkatëse kanë dërguar kërkesat për rishqyrtim të tyre sipas dispozitave të nenit 82 të LVL-së.

Bazuar në nenin 82.2 të LVL-së, komunat kanë rishqyrtuar në kuvendet e tyre 24 akte të kontestuar nga autoriteti mbikëqyrës.

Në përputhje me rekomandimet e dhëna komunat kanë harmonizuar 23 akte.

Komuna e Lipjanit 1 vendim të kundërligjshëm nuk e ka harmonizuar konform kërkesës së autoritetit mbikëqyrës edhe pas rishqyrtimit në kuvend.

Kurse, 1 vendim i Kuvendit të Komunës së Ferizajt është brenda afatit ligjor për rishqyrtim.

6 akte nuk janë kthyer për rishqyrtim në afatin prej 30 ditësh ashtu siç kërkohet me LVL.

Aktet të cilat nuk janë rishqyrtuar janë:

2 në Kuvendin e Komunës së Rahovecit

1 në Kuvendin e Komunës së Pejës

1 në Kuvendin e Komunës së Suharekës

1 në Kuvendin e Komunës së Graçanicës

1 në Kuvendin e Komunës së Parteshit.

Në vijim në formë Grafike është paraqitur numri i shkeljeve ligjore dhe veprimet e komunave në raport me kërkesat e autoritetit mbikëqyrës:




Fig.12.
Numri i akteve të kundërligjshme sipas komunave

Rishkimi administrativ




Fig. 13. Të dhënat për rishqyrtimin e akteve të kundërligjshme

Komunat	Gjakovë	Gilgovec	Dragash	Istog	Klinë	Kamenicë	Mitrovicë Jugore	Mitrovicë Veriore	Leposaviq	Lipjan	Novobërdë	Rahovec	Pejë	Prishtinë	Shtime	Suharekë	Ferizaj	Zubin Potok	Zveçan	Graçanicë	Partesh	Totali
Numri i akteve të kundërligjshme	2	1	1	1	1	3	1	1	1	1	1	2	1	1	1	1	1	2	3	4	1	31
Numri i akteve të rishqyrtuara dhe të harmonizuara me kërkesën për rishqyrtim	2	1	1	1	1	3	1	1	1	0	1	0	0	1	1	0		2	3	3	0	23
Numri i akteve të rishqyrtuara dhe të pa-harmonizuara me kërkesën për rishqyrtim		0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0		0	0	0	0	1
janë brenda afatit ligjor për rishqyrtim																	1					1
Numri i akteve të pashqyrtuara në afatin prej 30 ditësh pas dërgimit të kërkesës për ri-shqyrtim nga organi mbikëqyrës	0		0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	1	0	0	1		0	0	1	1	6

Tab.3. Procesi i rishqyrtimit të akteve të kundërligjshme



Në vijim janë paraqitur llojet e akteve të kundërligjshme sipas komunave si dhe veprimet e komunave në raport me kërkesat për rishqyrtim të akteve:

2 Gjakovë

1 Kuvendi i Komunës së Gjakovës ka bërë shkelje me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 011-2805 për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për ndërmarrje publike komunale "Stacioni i Autobusëve" Gjakovë. MAPL ka dërguar kërkesën për rishqyrtim me dt.02.04.2014. Lidhur me këtë, Kuvendi i Komunës së Gjakovës ka rishqyrtuar vendimin duke e shfuqizuar sipas kërkesës për rishqyrtim.

2 Kuvendi i Komunës së Gjakovës ka bërë shkelje ligjore me rastin e miratimit të Vendimit 01. nr. 011-4540 për shpalljen interes publik të pronës së paluajtshme të p.sh. "Ereniku" në ngastrën kadastrale Nr.5346, e cila i është dhënë në shfrytëzim KRU "Radoniqi". MAPL me dt. 09.06.2014 ka bërë shkresën për rishqyrtim. Kuvendi i Komunës së Gjakovës ka rishqyrtuar vendimin duke e harmonizuar me legjislacionin në fuqi.

2 Rahovec

1 Kuvendi i Komunës së Rahovecit ka bërë shkelje me rastin e nxjerrjes së Vendimit 01 NR.2292 DT. 30.05.2014 për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Rahovecit. MAPL ka vlerësuar se plotësim-ndryshimi i Statutit të Komunës nuk mund të bëhet me vendim pasi që është në kundërshtim me Ligjin për vetëqeverisje Lokale si dhe Rregulloren Nr.01/2013 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave me të cilën është përcaktuar se “amandamentimi, plotësimi ose shfuqizimi i një akti nënligjor të komunës bëhet nga akti i njëjtë nënligjor”. Komunës së Rahovecit i është dërguar kërkesa për ri-shqyrtim, mirëpo ky vendim nuk është rishqyrtuar në afatin ligjor.

Për këtë arsye, është mbajtur takimi me zyrtarët e Komunës së Rahovecit, ku është nxjerrë përfundimi se vendimi i lartpërmendur duhet të shfuqizohet, ndërsa procedura për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës duhet të bëhet sipas rregullave procedurale, ku përfshihet konsultimi i brendshëm, diskutimi publik, si dhe propozimi për ndryshimin e Statutit të bëhet në përputhje me Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe Rregulloren e lartpërmendur.

2 MAPL ka evidentuar shkelje me rastin e nxjerrjes së aktit të titulluar “Konkluzë” të miratuar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Rahovecit me dt. Dt. 30.05.2014. Ky akt është vlerësuar se nuk ka bazë ligjore, pasi që sipas LVL-së, kryesuesi i kuvendit të komunës nuk ka të drejtë të miratoj, plotësoj apo ndryshoj në emër të tij asnjë akt juridik i cili është në kompetencë të kuvendit apo organeve të administratës së komunës, çofshin akte administrative apo akte të përgjithshme juridike. E drejta për të ndryshuar aktet e përgjithshme juridike është e drejtë ekskluzive e Kuvendit të Komunës sipas nenit 12 të Ligjit nr.03 L-040 për Vetëqeverisje Lokale, ndërsa miratimi i akteve administrative është kompetencë e drejtorive të komunës dhe kryetarit të komunës. Për këtë rast është dërguar shkresa që Kuvendi i Komunës së Rahovecit në afatin prej 30 ditësh, konform nenit 82.2 të Ligjit Nr.03 L-040 për Vetëqeverisje Lokale të rishqyrtoj aktin e titulluar KONKLUZË 01 Nr. 2293 dt.30.05.2014 dhe të ndërmarr veprimet ligjore për nxjerrjen e akteve juridikisht të vlefshme të cilat janë në kompetencë të Kuvendit të Komunës sipas rekomandimeve në shkresë. Duke marrë parasysh se ky akt nuk është rishqyrtuar në afatin ligjor, është mbajtur takim me zyrtarët e komunës së Rahovecit përfshirë kryesuesin e kuvendit, ku është nxjerrë qëndrim se akti në fjalë të shfuqizohet në mbledhjen e radhës së kuvendit të komunës.

1 Istog



- Në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.04.2014, Kuvendi i Komunës së Istogut ka miratuar Vendim për plotësimin e Statutit të Komunës. Ky vendim është vlerësuar në kundërshtim me neni 12.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe me Rregulloren Nr.01/2013 për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunave.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për këtë çështje me datë 16.05.2014 ka dërguar shkresë për rishqyrtim në komunë. Konform kësaj kërkesë, Komuna e Istogut në mbledhjen e mbajtur me 30.05.2014 ka rishqyrtuar Vendimin brenda afatit të paraparë ligjor dhe e ka shfuqizuar sipas kërkesës.

1 Lipjan

- Në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.01.2014, Kuvendi i Komunës së Lipjanit ka miratuar vendim për emërimin e z.Sefer Tasholli, Nënkretar të Komunës për Komunitete. Ky vendim është konsideruar i kundërligjor nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për të cilin është dërguar shkresë për rishqyrtim. Kuvendi i Komunës nuk është përgjigjur brenda afatit ligjor për rishqyrtimin e vendimit në fjalë.

Duke marrë parasysh këtë, është realizuar vizitë në komunë, me ç'rast është arritur përfundimi që ky vendim të kthehet në rishqyrtim në mbledhjen e radhës të kuvendit. Për këtë çështje është pranuar zyrtarisht konfirmimi nga Kryetari i Komunës që në mbledhjen e radhës të kuvendit ky vendim të rishqyrtohet.

Megjithatë, edhe pse në mbledhjen e mbajtur me datë 26.05.2014 është rishqyrtuar vendimi në fjalë, kuvendi i komunës nuk ka ndërmarr veprimet për të harmonizuar atë me legjislacionin në fuqi, duke refuzuar kështu kërkesën e Kryetarit të Komunës dhe rekomandimin e MAPL-së për shkarkimin e Nënkretarit të Komunës për Komunitete.



1 Klinë

- Në komunën e Klinës është evidentuar shkelje ligjore me rastin e miratimit të Vendimit për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës së Klinës, lidhur me dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të tokës komunale, pjesë e ngas.kad.nr.567/2, në sipërfaqe të pjesërishtme prej 40 m2 dhe atë për ndërtimin e objektit të thertoresh në fshatin Videjë, që do të shërbejë për interesa publike të palëve kontraktuese për qytetarët e atij vendi dhe rrethinës.

Ky vendim është vlerësuar në kundërshtim me Ligjin Nr.04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (nenin 5) i cili përcakton se "procedura për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes konkurrencës së hapur publike dhe procedurave të parapara me këtë ligj".

MAPL me datë 16.05.2014 ka dërguar shkresën për rishqyrtim të këtij vendimi. Kuvendi i Komunës së Klinës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.05.2014 ka rishqyrtuar vendimin e lartpërmendur në përputhje me kërkesën e MAPL-së.

1 Novobërdë

- Kuvendi i Komunës së Novobërdës ka bërë shkelje me rastin e miratimit të Vendimit me Nr. 01-146 të dt.26.02.2014 lidhur me përbërjen e Komitetit për Komunitete. MAPL ka dërguar kërkesën për rishqyrtim dhe me dt. 27.03.2014 kuvendi i komunës ka harmonizuar vendimin sipas rekomandimeve të MAPL-së.

1 Pejë

- Në Komunën e Pejës është evidentuar një shkelje ligjore me rastin e nxjerrjes së vendit nga kuvendi i komunës për zgjedhjen e z.Elbert Krasniqi zëvendëskryesues për Komunitete të Kuvendit të Komunës. Ky vendim është vlerësuar i kundërligjshëm nga MAPL e cila me datë 04.02.2014 ka dërguar shkresë në komunë me të cilën ka kërkuar që kuvendi i Komunës brenda afatit prej 30 ditësh të kthejë atë në rishqyrtim. Komuna e Pejës nuk i është përgjigjur kërkesës për rishqyrtim të këtij vendimi. Edhe përkundër kërkesave të dhëna nga zyrtarët e MAPL-së në lidhje me këtë çështje, Komuna e Pejës ka rikonfirmuar qëndrimin se kjo pozitë është e domosdoshme për komunën, duke kontestuar njëherësh të dhënat e regjistrimit të popullsisë që sipas tyre nuk paraqesin gjendjen reale dhe se përqindja e komuniteteve joshumicë është më e madhe se ajo e paraqitur në të dhënat zyrtare të regjistrimit të popullsisë.

3 Kamenicë

- 1 Kuvendi i komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur më datën 10.01.2014, ka miratuar Vendimin për zgjedhjen e Zëvendës Kryesuesit për Komunitete. MAPL këtë vendim e ka vlerësuar të kundërligjshëm, për të cilin me datë 04.02.2014 ka dërguar shkresën për rishqyrtim. Konform kësaj kërkesë, komuna ka rishqyrtuar dhe harmonizuar vendimin në fjalë.
- 2 Kuvendi i komunës së Kamenicës ka bërë shkelje me rastin e nxjerrjes së Vendimit për ndryshimin e Statutit të Komunës. MAPL e ka konsideruar të kundërligjshëm këtë vendim dhe me datën 04.02.2014 ka dërguar shkresë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së këtij vendimi. Kuvendi i komunës së Kamenicës ka marrë parasysh kërkesën për rishqyrtim duke e shfuqizuar këtë vendim.
- 3 Kuvendi i Komunës së Kamenicës me dt. 28.02.2014 ka nxjerr Vendimin Nr. 01-7407 për formimin e komisionit vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim. Pas kërkesë për rishqyrtim të dërguar nga MAPL, ky vendim është shfuqizuar me dt. 10.03.2014 nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës.

1 Ferizaj

- Vendim dhe ate për themelimin e Ndërmarrjes Publike "Ambienti". Kuvendi i komunës së Ferizajt në mbledhjen e mbajtur më datën 27.05.2014, ka miratuar vendimin për Themelimin e Ndërmarrjes Publike "Ambienti" të cilin vendim MAPL e ka konsideruar si jo të ligjshëm dhe i cili vendim është në kundërshtim me nenin 11.1, të Ligjit Nr. 03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, MAPL, më datën 19.06.2014, i ka dërguar shkresën Komunës së Ferizajt, ku kërkon që nga komuna brenda afatit ligjorë të rishqyrtoj vendimin dhe konform shkresës së MAPL-së të harmonizoj më ligjet në fuqi.

1 Mitrovicë Jugore

- Kuvendi i komunës së Mitrovicës Jugore në mbledhjen e mbajtur më datën 16.01.2014, ka miratuar vendimin për formimin e Komitetit për Komunitete, të cilin vendim MAPL e ka konsideruar si jo të ligjshëm dhe në kundërshtim më LVL, dhe më datën 29.01.2014, i ka dërguar shkresën për rishqyrtimin e ligjshmërisë së këtij vendimi si dhe harmonizimin e këtij vendimi Kuvendi i Komunës së Mitrovicës konform më shkresën e MAPL-së ne mbledhjen e mbajtur më datën 10.03.2014.

1 Dragash

- Kuvendi i komunës së Dragashit në mbledhjen e mbajtur më datën 29.04, ka miratuar vendimin Vendimin për vend gjueti të cilin vendime MAPL e ka konsideruar si jo të ligjshëm dhe në kundërshtim më LVL. Me dt 25.06.2014 Kuvendi i Komunës së Dragashit e ka rishqyrtuar vendimin dhe harmonizuar me rekomandimin e MAPL-së.

1 Shtime

- Kuvendi i komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më datën 14.02.2014, ka miratuar vendimin për Themelimin e KKS-së, në kundërshtim më Udhëzimin Administrativ për themelimin e KKS-së, të cilin vendim MAPL e ka konsideruar si jo të ligjshëm dhe në kundërshtim më këtë udhëzim dhe i ka dërguar shkresën për rishqyrtimin e ligjshmërisë së këtij vendimi si dhe harmonizimin e këtij vendimi Kuvendi i komunës së Shtimes, konform më shkresën e MAPL-së ne mbledhjen e mbajtur më datën 10.03.2014.

1 Zubin Potok, Leposaviq, Mitrovicë Veriore dhe Zveçan

- Pas certifikimit të rezultateve zgjedhor dhe menjëherë pas konstituimit të organeve lokale ka filluar të rrjedhë afati 60 ditësh i paraparë nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, që obligon Komunitat që brenda këtij afati të miratojnë Statutet e tyre. Me këtë rast komunitat në fjalë ka funksionalizuar komisionet Statutare dhe kanë filluar me hartimin e Statuteve të tyre. MAPL, sipas mandatit ligjor, me qëllim të udhëzimit të Komunës gjatë procesit të hartimit të Statutit, ka organizuar takime konsultative me përfaqësuesit e Komunës si dhe ka dërguar model-Statutin e Komunës si një përkrahje konkrete. Megjithatë, pas miratimit të Statuteve në Kuvendet e Komunave Zubin Potok, Leposaviq, Mitrovicë Veriore dhe Zveçan, MAPL me rastin e vlerësimit të ligjshmërisë së këtyre statuteve, ka evidentuar një numër të shkeljeve ligjore që lidhen me: bazën ligjore, kufijtë administrativ të komunave, caktimin e zonave kadastrale, bashkëpunimin me organet dhe institucionet e Serbisë, pastaj organet e komunës, pozitën e zëvendës kryesuesit të kuvendit të komunës e cila nuk parashihet me LVL dhe është përcaktuar në Statutet e tyre, çështjen e iniciativave qytetare, bashkëpunimin në mes të komunave, menaxhimin e financave lokale si dhe çështje të tjera. Për të gjitha këto shkelje, MAPL ka adresuar vërejtjet në këto komuna duke përcaktuar afatin për rishqyrtim. Duke marrë parasysh shkeljet e konstatuara dhe kërkesat për rishqyrtim të parashtruara nga MAPL, Komunitat: Zubin Potok, Leposaviq, Mitrovicë Veriore dhe Zveçan kanë ndërmarrë veprimet procedurale duke përfshirë në agjendën e kuvendeve rishqyrtimin e Statuteve. Me këtë rast, janë inkuorporuar të gjitha vërejtjet e adresuara nga MAPL dhe si përfundim Statutet e Komunave në fjalë janë harmonizuar me legjislacionin në fuqi, ashtu sic është rekomanduar nga autoriteti mbikëqyrës.

1 Zubin Potok

- Në komunën e Zubin Potokut është evidentuar shkelje me rastin e miratimit të vendimit për zgjedhjen e Zgjedhja e Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës. Një pozitë e tillë nuk parashihet me Ligjin për Vetëqeverisje lokale, prandaj MAPL ka bërë kërkesë për rishqyrtim të këtij vendimi. Komuna në afatin ligjor ka ndërmarrë veprimet për rishqyrtim duke e shfuqizuar vendimin në fjalë dhe harmonizuar sipas kërkesës së MAPL-së.

2 Zveçan

- Në komunën e Zveçanit është evidentuar shkelje me rastin e miratimit të vendimit për zgjedhjen e Zgjedhja e Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës. Një pozitë e tillë nuk parashihet me Ligjin për Vetëqeverisje lokale, prandaj MAPL ka bërë kërkesë për rishqyrtim të këtij vendimi. Komuna në afatin ligjor ka ndërmarrë veprimet për rishqyrtim duke e shfuqizuar vendimin në fjalë dhe harmonizuar sipas kërkesës së MAPL-së.
- Kuvendi i Komunës së Zveçanit ka bërë shkelje me rastin e përcaktimit të përbërjes së Komitetit për politikë dhe financa. Vendimi është shqyrtuar nga MAPL, për të cilin është bërë kërkesa për rishqyrtim. Kuvendi i kësaj komune ka rishqyrtuar këtë vendim duke harmonizuar me rekomandimet e dhëna nga MAPL.

1 Partesh

- Kuvendi i Komunës së Graçanicës ka bërë shkelje me rastin e nxjerrjes së Vendimit nr. 041/2014, për refuzimin e ndërtimit të stacionit policor në Budrigë. MAPL ka bërë kërkesë për rishqyrtim të këtij vendimi, mirëpo komuna ende nuk ka rishqyrtuar vendimin në fjalë.

1 Prishtinë

- Shkelje e evidentuar: Propozim-rregullorja për të hyrat vetanke të institucioneve arsimore. Komuna ka rishqyrtuar aktin e kontestuar nga autoriteti mbikëqyrës.

4 Graçanicë

- Kuvendi i Komunës së Graçanicës ka bërë shkelje me rastin e miratimit të vendimit Nr. GB-88, për dhënien e hapësirave afariste në përdorim organizatave me interes të përgjithshëm. MAPL ka bërë shkresë për rishqyrtim të këtij vendimi dhe me datën 23.06.2014 Kuvendi i Komunës ka rishqyrtuar dhe harmonizuar këtë vendim sipas kërkesës së MAPL-së.
- Kuvendi i Komunës së Graçanicës ka bërë shkelje me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr. Gb-183 për zgjedhjen e zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës së Graçanicës. Pas kërkesës për rishqyrtim të MAPL-së, Kuvendi i Komunës me dt. 23.06.2014 ka rishqyrtuar dhe harmonizuar
- Kuvendi i Komunës së Graçanicës ka bërë shkelje me rastin e miratimit të Vendimit Nr. Gb-151 për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Pas kërkesës për rishqyrtim të vendimit të dërguar nga MAPL, me dt. 23.06.2014 kuvendi i komunës së Graçanicës ka rishqyrtuar dhe harmonizuar vendimin në fjalë.
- Kuvendi i Komunës së Graçanicës ka bërë shkelje me rastin e miratimit të Vendimit nr. GB-88 për dhënien e hapësirave afariste në përdorim organizatave me interes të përgjithshëm. Përkundër kërkesës së MAPL-së për rishqyrtim të këtij vendimi, Komuna e Graçanicës nuk ka adresuar për rishqyrtim vendimin e kontestuar.

1 Suharekë

- Shkelje e evidentuar: Vendim për iniciimin e procedurës për ndryshim të pjesshëm të PZHU-së të qytetit të Suharekës. Komuna nuk ka rishqyrtuar aktin e kontestuar nga autoriteti mbikëqyrës.

1 Glllogovc

- Shkelje e evidentuar: Ndryshim dhe plotësim i Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba. Akti është harmonizuar me datën, 28.04.2014.

Rekomandime

1. Komunitetët njoftojnë me kohë MAPL-në për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendeve të komunave, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.
2. Të mirëmbahen dhe funksionalizohen pajisjet elektronike për monitorim të mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave dhe vendosen konform U.A Nr. 2012/01 për monitorimin e kuvendeve të komunave përmes pajisjeve të teknologjisë informative "Teleprezencave".
3. Të zbatohen praktikatat më të mira për shpërndarjen e informatave për mbledhjet e kuvendit të komunës, duke përdorur format më efikase për informimin e qytetarëve.
4. Komunitetët vazhdojnë me dërgimin e akteve të Kuvendeve të Komunave në MAPL për vlerësim të ligjshmërisë, konform nenit 80.1 të LVL-së.
5. Të respektohen kërkesat e MAPL-së për rishqyrtim të akteve në afatin e paraparë ligjor.
6. Komunitetët shfrytëzojnë mundësinë e konsultimit paraprak.
7. Të respektohen parimet, kriteret dhe procedurat ligjore me rastin e miratimit të akteve juridike nënligjore, e në veçanti të respektohen procedurat ligjore për dhënie të pronës komunale në shfrytëzim.
8. Të respektohen dispozitat ligjore lidhur me dërgimin e procesverbaleve nga mbledhjet e KKSBB-ve në MAPL dhe MPB sipas U.A. të lartpërmendur.

